



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2019:253707

Datë: 02.12.2020

Numri i dokumentit: 01311220

P.nr.990/19

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin e vetëm gjykues Rilind Sermahaj, me pjesëmarrjen e zyrtare ligjore, në çështjen penale kundër të akuzuarit B. D. nga Gjilani, për shkak të veprës penale uzurpim i paligjshëm i pronës së paluajtshme nga neni 320 paragrafi 1 i KPRK-së, duke vepruar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan me numër PP.II.nr.1654/2019, të datës 31.10.2019, pas mbajtjes së seancave të shqyrtimit gjyqësor mori dhe publikisht me datën 09.11.2020 shpalli ndërsa me datë 01.12.2020, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari B. D., nga babai S. dhe nëna F., e lindur I., i lindur me datë ....., në Gjilan, ku edhe jeton, rruga ... nr..., ka të kryer shkollën e mesme, i martuar, baba i dy fëmijëve, i punësuar si menaxher në “...” në Gjilan, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës

ËSHTË FAJTOR

Sepse nga muaji nëntor i vitit 2016 në kohë të papërcaktuar, në vazhdimësi dhe pa ndërprerë tutje në Gjilan, i akuzuari B. D. në mënyrë të kundërligjshme ka uzurpuar pronën e paluajtshme të përbashkët-bodrumin e banesës, llamella ..., në rrugën ... përballë ish ... në Gjilan, në sipërfaqe prej 4-5 metra e evidentuar si pronë e përbashkët e banorëve të kësaj banese, në atë mënyrë që i akuzuari këtë bodrum pronë e përbashkët e të gjithë banorëve pa bazë ligjore dhe pa miratimin e banorëve e rrënon një muri dhe sipërfaqen prej 4-5 metra katror ia bashkangjet bodrumit të tij duke e rritur sipërfaqen hapësinore të bodrumit të tij në mënyrë të kundërligjshme për vete dhe në këtë mënyrë i akuzuari me veprimet e veta , e ka uzurpuar, e shfrytëzon dhe e mban në mënyrë të kundërligjshme pronën e paluajtshme të banorëve-pronarëve të kësaj njësie banesore të cilët e kanë të drejtën e shfrytëzimit në mënyrë proporcionale.

-Me çka ka kryer veprën penale uzurpimi i paligjshëm i pronës së paluajtshme nga neni 320 paragrafi 1 i KPRK-ës,

andaj gjykata në bazë të nenit 4,38,39,40,43,69,70,71 dhe 72 të KPRK-ës dhe neneve 359, 360, 361, 362 dhe 365 të KPP-ës, të akuzuarin B. D.:

## E GJYKON

Me dënim me gjobë në shumë prej 500 € (pesëqind euro), të cilin dënim i akuzuari obligohet që ta paguajë në afat prej 15 ditësh nga dita kur ky aktgjykim të merr formën e prerë.

Nëse i akuzuari nuk dëshiron, nuk mundet ose nuk është në gjendje ta paguaj dënimin me gjobë atëherë dënimi me gjobë do ti zëvendësohet në dënim me burgim në atë mënyrë që për çdo 20 € (njëzet euro) do ti caktohet një ditë burgim.

OBLIGOHET i akuzuari B. D. që pronën e uzurpuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi ta LIROJ në afat prej 15 ditësh nga dita kur ky aktgjykim të merr formën e prerë ndërsa gjykata në kuptim të nenit 463 paragrafi 2, të dëmtuarit për realizimin e pjesës tjetër të kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest të rregullt juridiko civil.

Obligohet i akuzuari i lartcekur që të paguajë paushallin gjyqësor në shumë prej 50 € (pesëdhjetë euro) si dhe shumën prej 30 € (tridhjetë euro) për kompensimin e viktimave të krimit, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

## A R S Y E T I M

### 1.Rrjedha e çështjes dhe fjala përfundimtare e palëve

Prokuroria Themelore në Gjilan-Departamenti i Përgjithshëm me 31.10.2020, ka ngritur aktakuzën PP.nr.1654/2019, kundër të akuzuarit B. D. nga Gjilani, për shkak të veprës penale uzurpim i paligjshëm i pronës së paluajtshme nga neni 320 paragrafi 1 i KPRK-së.

Gjykata me krijimin e kushteve ligjore me urdhër ka caktuar seancën e shqyrtimit gjyqësor për datë 23.09.2020, e të cilat seanca kanë vazhduar edhe me datat 03.11.2020 dhe 05.11.2020 dhe në të cilat janë administruar provat personale dhe materiale si dhe palët kanë dhënë edhe fjalët e tyre përfundimtare.

Prokurorja e shtetit në fjalën përfundimtare së pari kishte deklaruar se duke pasur parasysh se provat e shqyrtuara gjatë shqyrtimit gjyqësor kanë treguar se gjendja faktike ndryshon nga ajo e paraqitur në aktin akuzues sa i përket pronësisë së bodrumit të uzurpuar e njëjta në kuptim të nenit 350 të KPP ka bërë ndryshimin e aktit akuzues sa i përket gjendjes faktike ashtu që nga rreshti i gjashtë i dispozitivit të aktakuzës pas presjes është hequr pjesa e përshkruar dhe është shtuar *“në atë mënyrë që i akuzuari në këtë bodrum pronë e përbashkët e të gjithë banorëve pa bazë ligjore dhe pa miratimin e banorëve, e rrënon një muri dhe sipërfaqen prej 4 deri në 5 metra katror ia bashkangjet bodrumit të tij duke e rritur sipërfaqen hapësinorë të bodrumit të tij në mënyrë të kundërligjshme për vete dhe në këtë mënyrë i akuzuari me veprimet e tija ka uzurpuar e shfrytëzon dhe e mban në mënyrë të paligjshme pronën e paluajtshme të banorëve-pronarëve të kësaj njësie banesore të cilët e kanë të drejtën e shfrytëzimit në mënyrë proporcionale”*.

Po ashtu e njëjta kishte deklaruar se mbetet në tërësi pranë aktakuzës së ndryshuar me numër PP.IInr.1654/19 të datës 31.10.2019 dhe propozimeve që e njëjta përmban për faktin se gjatë seancave gjyqësore është vërtetuar se në veprimet e të akuzuarit B. D., në tërësi konsumohen elementet e veprës penale uzurpimi i paligjshëm i pronës së paluajtshme nga neni 320 paragrafi 1 i KPRK-së pasi që një gjë e tillë është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar gjatë administrimit të provave sikurse atyre personale e po ashtu edhe të atyre materiale dhe se është konstatuar se është fakt i pakontestueshëm se i akuzuari në mënyrë të kundërligjshme ka uzurpuar një pjesë të pronës së paluajtshme të përbashkët-bodrumin banesor e cila gjendet në objektin banesor Llamella ..., në rrugën “...” dhe atë në sipërfaqe prej 4-5 metra katrorë e evidentuar si pronë e përbashkët e banorëve të kësaj ndërtese banesore dhe këtë e ka bërë duke prishur një muri në bodrum me ç’rast dhe i ka bashkangjitur pjesën e shtuar bodrumit të tij duke e rritur në mënyrë të kundërligjshme sipërfaqen hapësinore për shfrytëzim për vete dhe se i akuzuari ka ndërmarrë një veprim të tillë u vërtetua edhe nga deklarata e A. K. i cili kishte theksuar se kishte banesën në katin e parë dhe bodrumi ishte pjesë e banesës së tij por në kadastrë nuk figuronte në emër të tij por si pronësi e përbashkët e të gjithë banorëve, një gjë e tillë është vërtetuar edhe nga deklaratat e dëshmitarëve S. I., A. R., R. S. dhe S. K., përkundër se të njëjtit theksuan se bodrumet ishin pronë e përbashkët e njësisë banesore, andaj prokuroria vlerëson se në veprimet e të akuzuarit në tërësi janë vërtetuar elementet inkriminuese të veprës penale uzurpimi i paligjshëm i pronës së paluajtshme nga neni 321 paragrafi 1 i KPRK-së prandaj edhe ka propozuar që i njëjti të shpallet fajtorë dhe ti jepet një dënim meritor sipas ligjit duke i pasur parasysh edhe rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, i cili do të përgjigjej të gjitha rrethanave të kryerjes së veprës penale dhe me të cilin do të arrihej qëllimi i dënimit po ashtu prokurorja e shtetit kishte propozuar që i akuzuarit të obligohet që ta lirojë pronën e uzurpuar dhe të njëjtën ta kthejë në gjendjen e mëparshme.

I dëmtuari A. K. në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e mbështet në tërësi fjalën përfundimtare të prokurores së shtetit dhe se nuk ka se çfarë të shtoj tjetër.

Mbrojtësi i të akuzuarit B. D. avokati Mustafë Nuhiu në fjalën përfundimtare sa i përket ndryshimit të aktit akuzues kishte deklaruar se konsideron se edhe pas ndryshimit të dispozitivit të aktakuzës pra përshkrimi faktik në aktakuzë, vlerëson se edhe pas këtij ndryshimi nga ana e prokurorisë nuk është vërtetuar se prona e cilësuar si e përbashkët në këtë ndërtesë është pronë e gjithë banorëve të saj, e lidhur me këtë nga ana e prokurorisë nuk është prezantuar dëshmi pronësore lidhur me titullarin e këtij bodrumi, sepse provat e paraqitura në shqyrtim gjyqësorë nuk paraqesin asnjë bazë të vetme ligjore dhe vendimtare për gjetjen e fajësisë të të akuzuarit lidhur me veprën penale për të cilën akuzohet dhe se gjatë zhvillimit të procedurës penale bazuar në shkresat e lëndës është vërtetuar se nuk ka prova të mjaftueshme për të mbështetur dyshimin e bazuar mirë se i akuzuari ta ketë kryer veprën penale për të cilën akuzohet. Prokuroria e ka ngritur aktin akuzues pa asnjë provë materiale por vetëm mbi bazën e deklaramit të të dëmtuarit A. ndërsa në rastin konkret nuk është vërtetuar fare se palë e dëmtuar është personi A. K., tutje ashtu siç ka deklaruar i akuzuari, për asnjë moment nuk ka pretenduar ta përvetësojë këtë hapësirë të bodrumit, e kjo për faktin se i njëjti ka hapësirë të mjaftueshme në pronësi juridike të veten (59.88 metër katrorë), *por kufizimin e kësaj hapësire e ka bërë me të vetmin qëllim që të eliminojë mundësinë e dëmtimit të mëtutjeshëm të gypit të*

*kanalizimit*, gjykata duhet gjithashtu ta ketë parasysh faktin se i akuzuari është njeri familjar, kujdeset dhe është mbajtës i familjes dhe i njejtë për herë të parë është paraqitur para gjykatës dhe ndaj ti nuk është zhvilluar asnjëherë më parë procedurë penale, andaj pas të gjitha të lartcekurave ka kërkuar nga gjykata që në kuptim të nenit 364 paragrafi 1.1 dhe 1.3 të KPP-ës, të merret aktgjykim lirues ndaj të akuzuarit sepse vepra për të cilën akuzohet, nuk përbën vepër penale dhe nuk është provuar se i akuzuari ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

I akuzuari B. D. në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë fjalës përfundimtare të mbrojtësit së tij dhe nuk ka se çfarë të shtojë tjetër.

## 2.Provat e administruara gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësor

Pas prezantimit të provave, gjykata plotësisht dhe përtej çdo dyshimi të bazuar mirë ka vërtetuar gjendjen faktike si në dispozitiv të aktgjykimit, këtë gjendje faktike gjykata e vërtetoi në bazë të:

- Dëgjimit të të dëmtuarit në cilësinë e dëshmitarit A. K.,
- Dëgjimit të dëshmitarit S. I.,
- Dëgjimit të dëshmitarja A. R.,
- Dëgjimi i dëshmitari S. K.,
- Leximi i deklaratës së dëshmitares R. S. të dhënë në polici me datë 12.09.2019 dhe leximit dhe shikimit të provave materiale si: raporti fillestar i rastit, raporti i oficerit me nr. Të rastit 2019 –CA – 0532 i datë 24.04.2019, deklaratat e të dëmtuarit e dhënë në polici, deklaratat e dëshmitareve të dhëna në polici, deklaratat e të akuzuarit e dhënë në polici, fleta poseduese dhe kontrata për shitblerje të pronës e noterizuar me numër OPR.BR 0710/2017 me nr. Të referencës 0162/20107 e datë 08.02.2017, kontrata e datës 12.02.1992, aktvendimi i datës 14.01.2019 aktvendimi i datës 22.12.2018, identifikimi- regjistrimi i pjesëve të ndërtesave i datës 16.10.2019, identifikimi-regjistrimi i pjesëve të ndërtesave i datës 20.03.2017, aktvendimi i datës 21.06.2018, vërejtje e datës 17.10.2003, kontrata e shitblerjeje e S. P., fotografit nga vendi i ngjarjes dhe
- Mbrojtja e të akuzuarit B. D..

### 2.1.Deklarata e të dëmtuarit në cilësinë e dëshmitarit A. K.

I dëmtuari A. K. në cilësinë e dëshmitarit në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se: B. D. nuk e ka njohur më herët ndërsa si familje po, banesën e ka te ish ndërtesa e KEK-ut përball ..., banesën i njejtë e ka në katin e parë të banimit dhe bodrumi kontestues është pjesë e banesës, i cili bodrum sipas pronarit të banesës i cili ia ka shitur banesën atij është diku në sipërfaqe prej 15 metra, ngase e njëjta në përpjesëtim me të gjitha banesat, banesa figuron në emrin e tij në kadastër ndërsa *bodrumi është pjesë e përbashkët e hyrjes së banesës*, i akuzuari B. D. nuk e ka lokalitë në hyrjen e tij, i dëmtuari A. banesën e tij e kishte blerë diku në vitin 2010, mirëpo nuk kishte hyrë në posedim deri në vitin 2017 kur nga aty me anë të policisë kishte larguar një uzurpator të banesës së tij, kur kishte shkuar poshtë në bodrum ai kishte qenë i lirë pra nuk ishte qenë i thurur, pastaj në muajin shtator të viti 2017 e kishte shikuar

podrumin dhe i njëjti kishte qenë i thurur, një kohë nuk e kishte ditur se kush e kishte uzurpuar podrumin, pastaj kishte hulumtuar se kush e ka thurur bodrumin dhe një prej banorëve i kishte treguar se e ka uzurpuar ky i "...” - (i akuzuari), dhe kur kishte shkuar për të biseduar, me tani të akuzuarin i njëjti në mënyrën më të sinqertë e kishte pranuar dhe i kishte thënë se nuk e ka ditur se i kujt është sepse e njëjta ka qenë e zbrazët për 10 vite dhe në atë moment i njëjti i kishte thënë t’ia shes por i dëmtuari A. i ishte përgjigjur se nuk mund ta shes pasi që njëjta është pronë e përbashkët dhe pasi që i kishte thënë se nuk mund ta shes i akuzuari i kishte thënë se a po ma len në shfrytëzim edhe këtë vit dhe ky i ishte përgjigjur që mund ta shfrytëzosh edhe gjatë vitit 2018 por në fund duhet të ma lirosh, më tutje shton se me të akuzuarin kishte lidhur marrëveshje me qëllim për të ma liruar bodrumin, e cila marrëveshje është lidhur me datën 06.07.2017 ndërsa kur erdhi koha për t’ia liruar bodrumin i njëjti nuk e kishte liruar, dhe i kishte thënë se po e këqyri me ble një bodrum tjetër e pastaj ti ma lenë këtë në shfrytëzim e unë ta jap atë tjetrin që e blejë, hera e fundit kur ka kërkuar që të i lirohet bodrumi ka qenë në mars të vitit 2019 dhe se i akuzuari i kishte thënë se nuk do ta lirojë bodrumin, i njëjti ka shtuar se vetëm banuesit e banesave e kanë të drejtën e shfrytëzimit të përbashkët të bodrumit dhe se në bodrumin kontestuese të gjitha pjesët janë të ndara për banuesit që jetojnë në atë banesë.

## 2.2.Deklarata e dëshmitarit S. I.

Dëshmitari S. I. në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se në banesën të ish KEK-ut jeton që nga viti 2001, banesën e ka në katin e 5-të dhe se në këtë objekt ka bodrum 2 metra katror të cilin e ka thurur vetë dhe ia ka dhënë në shfrytëzim B. për me lenë ndonjë gjë dhe se është pronar i banesës me letra ndërsa sa i përket bodrumit në kontratë vetëm përmendet se ka bodrum e jo kush sa ka, do të thotë në kontratë nuk specifikohet se kush sa metra bodrum i ka por aty kush sa ka mundur edhe qysh ka mundur ka zënë bodrum dhe se nuk e di se a kanë të drejtë edhe lokalet me shfrytëzu pjesë të bodrumit, por se B. pjesën e tij të bodrumit ia ka dhënë në shfrytëzim pa pagesë vetëm që ta shfrytëzoj nëse i vyen ndonjë gjë për shkak të firmës që e posedon, kjo pasi B.i i ka ndihmuar banorët e banesës me rregullimin e gypave në pjesën e vetë ku ka pasur prishje dhe se po ashtu edhe A. ka banesë në katin e parë të banesës dhe se nuk e di se a ka apo jo A. bodrum aty, nuk e di nëse A. ka pas apo jo probleme me B. për bodrum, se në atë bodrum gjithë banorët kanë marrë sa kanë dashtë dhe e kanë rrethuar secili pjesën e vet kujt sa i ka vyer, kush ka qenë i zoti ka mund të marrë sa ma shumë metra në bodrum. Dëshmitari tutje kishte deklaruar se e di që nuk ka ndonjë pjesë tjetër në bodrum që është e lirë, kjo pasi që të gjitha pjesët e bodrumit janë të rrethuara, ky uzurpim dhe kjo ndarje e bodrumeve ka filluar menjëherë pas luftës, por e di cilën pjesë e ka në shfrytëzim B., nuk e di se a është e uzurpuar.

## 2.3.Deklarata e dëshmitarja A.R..

Dëshmitarja A. R. në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se banesën e ka në rrugën “...” përmbi “..”, në katin e tretë të banimit, dhe se të njëjtën e ka trashëguar nga babi dhe e njëjta figuron në emrin e sajë, banesa ku ajo jeton ka pasur bodrum deri para luftës së vitit 1999 të cilën e kanë shfrytëzuar gjatë luftës, e që nga viti 1999 më nuk ka qasje në bodrum dhe asnjë hapësirë më të vogël në bodrum, kjo për shkak se para luftës bodrumi ka qenë i ndarë me letra

dhe secili prej 12 banorëve përkatësisht banesat nga numri 1 deri në nr. 12 kanë pasur bodrume dhe se kjo cekët edhe në kontratën e shitblerjes ku shkruhet se i takon edhe një bodrum, dhe se bodrumin ka pasur të drejtë ta shfrytëzoj secili prej banorëve, këtë bodrum kanë pasur të drejtë ta shfrytëzojmë aq sa e kanë hapësirën e banesës, ndërsa gjatë vitit 1999 letfet me të cilat kanë qenë të ndara pjesë e bodrumit janë prishur për me pas hapësirë që banorët e banesave ku të qëndrojmë gjatë bombardimeve, dhe pas vitit 1999 këto letfe janë prishur dhe kujt sa iu ka dashtë e kanë rrethuar bodrumin, dhe se e njeh edhe të akuzuarin të cilin e ka komshi, ndërsa të dëmtuarin po ashtu e njeh por se i njejtë kishte shkuar më vonë në atë banesë, ndërsa e vetmja banuese që nga para lufta në atë banesë është kjo, dhe atë që nga viti 1988 sepse banesat e tjera janë shitur. Më tutje dëshmitarja kishte deklaruar se në atë objekt banesë ka i dëmtuari, ndërsa B. nuk ka banesë. Dhe se nuk e di se kush ka bodrum në bodrumin kontestues, por mund të thotë se për vete kjo nuk ka, e kjo sepse të gjitha janë të uzurpuara. Dhe se e ka njohur personin prej kujt e ke ble banesën i dëmtuari, dhe se pjesa e bodrumit të banesës së të dëmtuarit ka qenë numër 2 pasi që banesa e tij është numër dy, ndërsa banesa në të cilën jeton është blerë nga ushtria e ish Jugosllavisë, dhe se bodrumin e ka në kontratë dhe mendon se edhe në kadastër duhet të jetë edhe pjesa e bodrumit nga se edhe për atë pjesë ka paguar tatim, para luftës bodrumet kanë qenë të ndarë në dy pjesë me nga 6 bodrume dhe secila prej banesave e kanë pasur numrin në bodrum, dhe *se e di se B. e ka pasur në shfrytëzim lokal in të cilin e ka pasur në shfrytëzim baba i vetë para luftës së vitit 1999, dhe se i njejtë nuk ka pasur bodrum por vetëm lokal.* E njëjta ka shtuar se nuk e di nëse në fletën poseduese shkruan se ajo posedon edhe bodrumin apo jo, dhe asnjëherë nuk kishte pasur asgjë kontestuese sa i përket bodrumit, dhe se si banor të objektit asnjëherë nuk kanë marrë iniciativë për ta ndarjen fizike të bodrumit.

#### 2.4.Deklarata e të dëshmitarit S.K.

Në seancën e shqyrtimit gjyqësor dëshmitari S. K. ka deklaruar se për këtë çështje kishte dhënë deklaratë edhe në polici dhe mbetet në tërësi pranë deklaratës së lartcekur, dhe se jeton në objektin banesor ku gjendet ky bodrum, dhe se fillimisht kur e ka marrë në pyetje policia i kanë thënë se edhe ju jeni i akuzuar nga i dëmtuari për uzurpim, ndërsa i pari person që ka ble banesë në atë hyrje është vet ky dëshmitar përveç një personi tjetër shqiptar i cili ka qenë aty edhe para luftës pasi që para luftës kjo banesë kishte qenë hyrje e oficerëve të Serbisë në atë kohë dhe kur e ka blerë banesën ka dashur që të njëjtën ta rinovoj, e për ta rinovuar është dashur që të hyjë në bodrum dhe ta ndalë ujin, ndërsa aty nuk ka pasur kushte me hy për arsye se ka qenë bodrumi i mbushur me ujë dhe mbeturina, dhe se e ka pastruar vetë atë bodrum me shpenzime të tija dhe në atë kohë nuk ka pasur asnjë ndarje të bodrumit, aty ka qenë hapësirë dhe i njejtë shton se madje kur e ka pastruar aty “ke mujt me lu edhe futboll”, në atë pjesë të cilën e ka pastruar nuk ka bodrum sepse pronari nga i cili e ka blerë banesën ka qenë teknik në ... e cila e ka ndërtuar atë objekt dhe njëherit ka qenë edhe mirëmbajtës i asaj hyrje të banesës së oficerëve dhe bodrumi të cilën e ka pasur pronari i mëparshëm i banesës për të cilin nuk ka pasur letra ka qenë nën shkallë, sikurse nuk ka informata se nga hyrja e banesës dikush ka dokumente valide se ka pjesë të bodrumit, dhe se nuk e di për çka është i destinuar bodrumi sepse me sa e di kërkush nuk ka letra për atë bodrum, tutje dëshmitari ka deklaruar se banesa e tij gjendet në katin e fundit të banesës ndërsa A. K. e ka banesën në katin e parë dhe e di që e

ka blerë vitin e kaluar, ndërsa në atë podrum kush ka dashtë ka zënë pjesë të bodrumit dhe e kanë ndarë qysh kanë dashtë, e pjesa e bodrumit të cilën e ka edhe e ka pasur edhe pronari i mëparshëm e cila gjendet nën shkallë e i cili ka qenë i ndarë paraluftës, e për dallim që të tjerat janë ndarë pas luftës, e shfrytëzon ende dhe se për të njëjtin nuk posedon dokumentacion mirëpo vetëm ka marrëveshje gojore me pronarin e mëparshëm, e me A. ka kontakt të përditshëm por i njëjti nuk i ka shfaqur asnjë shqetësim lidhur me këtë bodrum: Në atë pjesë të bodrumit asnjë prej banorëve nuk ka pasur bodrum e as B. dhe se nuk e di nëse e shfrytëzon ndonjëri prej banoreve atë bodrum, por e di që kanë bërë ndarje por kush e shfrytëzon nuk e di. Në muajin maj të vitit 2000 e ka pastruar atë bodrum, i cili nuk ka pasur ndarje në atë kohë ndërsa hera e fundit që ka hyrë në atë bodrum ka qenë para një muaji e gjysmë dhe e ka parë se afër hidroforëve që i ka rregulluar ai vetë, ka qenë një pjesë e lirë e tani edhe ajo pjesë është ndarë, dhe se ka qenë edhe një hapësire në fund në anën e majtë të cilën nuk ka bërë ndarje askush pasi që ka qenë një kanalizim dhe ka pasur fekale, e tash kam njohuri që në atë pjesë ku gjendet kanalizimi e ka muratuar B. ashtu dua të shtojë se B. ka me vite që ka probleme me kanalizimin e banesës gjithashtu nuk e di se asnjë bodrum kujt i përket aty pasi që personalisht askush nga fqinjët nuk ka dokumentacion për bodrum.

#### 2.5.Deklarata e dëshmitares R. S..

Meqenëse dëshmitarja R. S. kishte munguar në seancat e shqyrtimit gjyqësor edhe pse e njëjti kishte qenë e ftuar në mënyrë të rregullt nga ana e gjykatës mirëpo sipas fletë kthesave është konstatuar se e njëjta jeton jashtë shtetit andaj me pëlqimin e palëve dhe në kuptim të nenit 338 paragrafi 1, nën paragrafi 1.3 të KPP-ës, deklarata e saj e dhënë në polici me datë 12.09.2019 është lexuar, deklaratë kjo në të cilën dëshmitarja e lartcekur kishte deklaruar se në atë bllok të ndërtesës jeton më shumë se 20 vite dhe se në ndërtesë është një podrum i përbashkët për të gjithë banorët e ndërtesës dhe se është e vërtetë se nga numri 1 deri në 12 të gjithë banorëve të banesës i takon nga një podrum. Por se në kontratën e saj të blerjes së banesës nuk kishte figuruar edhe shfrytëzimi i podrumit të kësaj banese, por është e vërtetë se e ka shfrytëzuar një pjesë të podrumit edhe ende e ka në shfrytëzim. Nuk ka pasur njohuri se A. K. ishte ankuar në polici për pronarin e ... (të akuzuarin) deri në momentin që ishte ftuar për intervistim nga ana e policisë dhe se *e di se edhe më herët B. D. ka uzurpuar një podrum që nuk është i tij* dhe se edhe dëshmitarja e shfrytëzon një podrum në këtë ndërtesë gati që nga fillimi i blerjes së banesës, edhe ka bërë një ndarje fizike në mes podrumeve tjerë, pasi që disa banorë filluan ti ndajnë podrumet e veta e pastaj edhe kjo ju kishte bashkangjitur në afërsi të podrumeve dhe e kishte rregulluar podrumin për veti, ndarjen e podrumeve e kishin bërë për arsye që secili prej banorëve të banesave me numër ti mbetet nga një podrum për afërsisht me sipërfaqe të njëjtë.

#### 2.6.Mbrojtja e të akuzuarit B. D.

Në seancën e shqyrtimit gjyqësor i akuzuari B. D. gjatë dhënies së mbrojtjes së tij ka deklaruar se është pronar juridik i lokalit me 155 metra katror edhe me podrum prej 59.88 metra katrorë dhe atë është bashkëpronar me dy vëllezërit e H. D.. dhe B.D, pronar juridik të lokalit janë që nga viti 2001 kur e kanë blerë nga ndërmarrja “..” me seli në Maqedoni, prindërit e tij në atë lokal kanë punuar që nga viti 1977 kur është ndërtuar objekti pasi që të njëjtit kanë punuar si punëtor në ndërmarrjen “..”, në bodrumin e banesës nuk ka ndonjë hapësire të pa shfrytëzuar

përveç një pjesë ku janë të vendosura pompat e ujit për banesë, bodrumi më parë nuk ka qenë i ndarë asnjëherë sikurse ka thënë edhe dëshmitari S. K. dhe dëshmitarët e tjerë, ndërsa ndarja e bodrumit ka filluar kur ka pasur krizë për energji elektrike menjëherë pas luftës përafërsisht në vitin 1999-2000, ku në një pjesë të bodrumit ku kalojnë pjesë e kanalizimit e të cilën nuk e ka marrë askush sepse ka qenë hapësire problematike, pasi që ka sjell ndotje dhe mbyllef kanalizimi mirëpo i akuzuari *këtë pjesë e kishte rrethuar për shkak të sigurisë së bodrumit të tij sepse ky kanalizim i kishte sjellur probleme ne lokal, dhe se nuk pretendon se kjo pjesë është e tija, por se është e përbashkët dhe ai e konsideron që është pronë e gjithë banorëve, pasi që e shfrytëzon këtë pjesë por se e bënë për siguri dhe se për këtë arsye edhe e ka rrethuar* ndërsa A. K. nuk është pronar i kësaj pjese të bodrumit, sepse ai podrum ka qenë i destinuar për strehimore në rast të luftës edhe atë për të gjithë qytetarët e jo ekskluzivisht vetëm për banorët e ndërtesës dhe asnjë prej banorëve pjesët e tyre të bodrumeve nuk i ka me dokumente, e ketë e ka vërtetuar edhe në kadastër. *Dhe nuk pretendon që këtë pjesë të bodrumit prej 3.80 metra katror ta përkthej në emrin e tij sepse bodrumin e ka rrethuar për sigurinë e bodrumit të tij sepse në atë pjesë gjendet kanalizimi dhe në të kaluarën i ka sjellur dëme në bodrumin e tij në të cilin gjenden pjesë të tekstilit veshmbathje dhe patika të cilat i shet në lokalin e tij, ai e di se A. K. ka një pjesë tjetër të bodrumit të cilin shfrytëzon, dhe se nuk ka njohuri nëse edhe dikush tjetër nga banorët e asaj ndërtese përveç A. është ankuar për këtë pjesë të bodrumit, sepse të tjerët kanë qenë falënderues për pastrimin dhe renovimin e asaj pjesë ku gjendet kanalizimi, në fletën posedues figuron sipërfaqja e bodrumit pre 59 metra katror dhe atë në emrin e babit të tij S. D., e për të cilin ka dëshmi edhe fletën poseduese gjithashtu i njejt ka deklaruar se *e pranon se e shfrytëzon edhe pjesën tjetër prej 3-4 metra katror të sipërfaqes të cilën e ka rrethuar për arsyet të lartcekura, dhe këtë hapësire e shfrytëzon nga viti 2017, kjo pasi që kjo hapësirë është e ngjitur me pjesën e bodrumit të tij dhe i është dashur që ta prishi një muri të bodrumit të tij prej 1 metër e gjysmë që ta rregullojnë atë mirëpo me shkrim nuk ka marrë asnjë konfirmim nga banoret përveç se gojarisht, i njejt e ka ditur edhe faktin që edhe pjesët e tjera të bodrumit të cilët i kanë pjesët e tyre që të gjitha janë të uzurpuara, dhe përveç tij që e ka me letra bodrumin ne hapësire prej 59 metra katror asnjë prej banorëve të tjerë nuk i kane me letra pjesët e tjera.* Dhe lokalin kur e kishte blere nga shitësi Astibo, e kishte blere edhe me bodrum dhe për këtë arsye vetëm konsideron se e ka atë pjesë të bodrumin në emrin e tij, dhe ajo hapësire e bodrumit ka qenë e destinuar për strehimore në rast të luftës e jo për banorët, dhe se nuk është e vërtetë se këto hapësira të bodrumit kanë qenë ndonjëherë të ndara me numra sepse bodrumi ka qenë hapësire e hapur për strehimore, dhe kjo hapësire që ka qenë e dedikuar për strehimore ka edhe dritare për ventilim. *I njejt deklaroi se momentalisht ne atë bodrum i shfrytëzon 63 metra katror e diçka, ndërsa sa i përket marrëveshjes së datë 01.06.2017 me A. K., i njejt kishte qenë duke fshi para dyqanit dhe kishte shkuar A. dhe i kishte thënë qysh bre djalë e uzurpon bodrumin me një agresivitet dhe me një vetëbesim të madh ndërsa rrethanat nuk i kishte ditur në atë kohe prandaj dhe i kishte se thënë nëse ti ke dëshmi se bodrumi është i yti unë në çdo moment jam i gatshëm që ta kthej atë hapësirë, ndërsa personi në fjale i kishte sjellur një kontratë për bodrum në të cilën shkruante serbisht O.. por nuk e kishte ditur dhe me pastaj e kishte kuptuar më vonë se ajo kishte të beje me një banesë tjetër, mirëpo këtë fakt e kishte kuptuar kur e kishte bartur bodrumin ne emrin e tij dhe e kishte nënshkruar marrëveshjen duke mos e ditur se nuk posedon ai dokumente valide për atë pjesë të bodrumit d.m.th. ka qenë mashtrim nga ana e tij, dhe se kur e kishte kuptuar nga drejtorja e kadastrit se**



kërkush nuk ka pjesë në atë bodrum i kishte thënë që pa ma sjellur skicën ose kopjen e kontratës për atë bodrum *unë nuk e lirojë atë pjesë të bodrumit*, pas kësaj A. kishte uzurpuar një pjesë tjetër të bodrumit dhe kur e kishte parë që i njëjti po pretendon edhe për këtë pjesë, e kishte parë që njëjti ka qëllimin që me marrë pare e jo për me marrë në shfrytëzim atë sipërfaqe të bodrumit.

### 3. Vlerësimi dhe analizimi i provave

Në seancat e shqyrtimit gjyqësor në këtë çështje penale, gjykata komfor nenit 7 të KPP-së, saktësisht dhe në mënyrë të plotë vërtetoi faktet që janë të rëndësishme për marrjen e vendimit të ligjshëm, me vëmendje dhe përkushtim maksimal profesional dhe me përkujdesje të njëjtë vërtetoi faktet kundër të akuzuarit si dhe ato në favor të tij duke i mundësuar të akuzuarit shfrytëzimin e të gjitha fakteve dhe provave që janë në favor të mbrojtjes dhe me ndërgjegje vlerësoi çdo provë një nga një dhe në lidhje me provat tjera dhe në bazë të vlerësimit të tillë ka nxjerr përfundimin lidhur me faktet konkrete të vërtetuara me ç'rast pas analizimit dhe vlerësimit të provave të cilat janë administruar në seancën e shqyrtimit gjyqësor, ka ardhur në përfundim se deklaratës së deklaratës së të dëmtuarit A. K., deklaratës së dëshmitarëve S. M., A. R., S. K. dhe R. S. duhet t'iu falet besimi ngase të njëjtat janë në harmoni me njëra tjetrën e po ashtu edhe me provat e tjera materiale të cilat janë administruar nga ana e gjykatës dhe në bazë të cilave gjykata ka vërtetuar përtej dyshimi të bazuar mirë se i akuzuari B. D. ka kryer veprën penale uzurpimi i paligjshëm i pronës së paluajtshme nga neni 320 paragrafi 1 i KPRK-ës.

Gjykata pas analizimit dhe administrimit të provave personale dhe materiale në këtë çështje penalo juridike gjeti se nuk ishte kontestuese se bodrumi i ndërtesës e cila gjendet në Gjilan, në rrugën "...", lllamella ..., përballë ish .... ishte në pronësi të përbashkët e të gjithë banorëve në atë ndërtesë ngase një fakt i tillë është vërtetuar nga deklaratat e dëshmitarëve A. K., S. Mu., A. R., pjesërisht nga deklarata të dëshmitarit S. K. dhe R. S. të cilët sa i përket pronësisë njëjtë kishin deklaruar se bodrumi i ndërtesës është pronësi e përbashkët e të gjithë banorëve, po ashtu ky fakt është vërtetuar edhe nga fleta poseduese me numër .... të datës 25.09.2018 në të cilën sa i përket pronësisë në bodrumin e ndërtesës thuhet se ajo është pjesë e përbashkët për njësitë e veçanta banesore, po ashtu nuk ishte kontestues as fakti në këtë bodrum kishte pjesë të tij edhe vet i akuzuari sepse ky fakt është vërtetuar nga deklarata e të akuzuarit, të dëmtuarit, dëshmitarëve dhe më së miri nga provat materiale si identifikimi-regjistrimi i pjesëve të ndërtesës me numër ... si dhe vet certifikata e pronësisë me numër ..., të datës 26.11.2018 përmes të cilave vërtetohet fakti se B. D. është pronar juridik i bodrumit në sipërfaqe prej 59.88 metra katror në këtë njësi banesore përkatësisht në këtë bodrum, po ashtu nuk ishte kontestues as fakti se në këtë bodrum ishin muratuar edhe pjesë të tjera të bodrumit nga ana e banorëve të kësaj ndërtese sepse një fakt i tillë është vërtetuar nga deklarata e dëshmitarëve si dhe vet të akuzuarit mirëpo pas të lartcekurave gjykata gjeti se në këtë çështje penalo juridike ishte kontestues fakti nëse i akuzuari B. kishte bërë uzurpimin e sipërfaqes prej 4-5 metra katror të cilën sipërfaqe ia kishte bashkangjitur bodrumit të tij edhe pse e dinte se kjo sipërfaqe nuk është në pronësinë e tij por është pronë e përbashkët e të gjithë banorëve të ndërtesës.

Gjykata këtë fakt kontestues e zgjodhi duke u bazuar në deklaratat e dëshmitarëve të cilët gjithë njësoj kishin deklaruar se pjesa prej 3-4 metra të cilën e kishte muratuar i akuzuari kishte qenë e lirë dhe njëkohësisht edhe problematike për shkak të kanalizimit i cili kalonte në atë pjesë, të lartcekurit po ashtu njësoj kishin deklaruar se këtë pjesë e kishte muratuar i akuzuari B. D. i cili këtë pjesë ia kishte bashkangjitur bodrumit të cilën e posedonte vet ai po ashtu ky fakt kontestues mbi të gjitha gjen mbështetje dhe vërtetohet edhe në vet mbrojtjen e të akuzuarit i cili nuk e kishte mohuar një fakt të tillë dhe ndër të tjera kishte deklaruar se *“momentalisht në atë bodrum i shfrytëzon 63 metra katror e diçka” dhe “se e pranon se e shfrytëzon edhe pjesën tjetër prej 3-4 metra katror të sipërfaqes të cilën e ka rrethuar për arsyt të lartcekura (për shkak të kundërmimit nga kanalizimi) dhe këtë hapësirë e shfrytëzon nga viti 2017”,* çka nënkupton se as vet i akuzuari nuk e mohon se edhe pse e ka ditur se nuk është pronar i asaj sipërfaqe si në dispozitiv të këtij aktgjykimi i njejtë e ka muratuar atë dhe ia ka bashkangjitur bodrumit të tij për të cilën është edhe pronar juridik andaj përmes të lartcekurave gjykata vërtetoi edhe elementin subjektiv përkatësisht dashjen tek i akuzuari për ta kryer këtë veprë penale dhe rrjedhimisht në këtë çështje penalo juridike gjykata konsideron se është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë se i akuzuari B. D. në mënyrë të kundërligjshme ka uzurpuar pronën e huaj-bodrumin i cili është pjesë e përbashkët e banorëve të ndërtesës edhe atë në hapësirë prej 4-5 metra katror edhe pse e ka ditur se ajo pronë nuk është e tija dhe njëkohësisht në veprimet e të akuzuarit janë konsumuar elementet e veprës penale të uzurpimit të paligjshëm të pronës së paluajtshme nga neni 320 paragrafi 1 i KPRK-ës.

Pas vërtetimit të gjendjes faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi gjykata sa i përket provave materiale të cilat janë administruar gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësor siç ishin raporti i oficerit, aktvendimi T.nt.179/2008, certifikatës së pronësisë në emër të A. K., kontratës me numër 0710/2017 dhe numër të referencës 0162/2017, të datës 08.12.2017, në emër të A. K., kontratës me numër 684-3, të vitit 1992, kontratës së shitblerjes në emër të R. S., kontratës me numër 117794 nuk është lëshuar në vlerësimin e mëtejshëm të tyre meqenëse të njëjtat nuk kishin ndonjë rëndësi për vërtetimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike sepse të njëjtat kishin të bëjnë me mënyrat e fitimit të pronësisë për banesat respektive të banorëve të atyre banesave në ndërtesën ku gjendej bodrumi i cili ishte objekt i aktakuzës lëndore.

#### 4.Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata erdhi në përfundim që është vërtetuar plotësisht gjendja faktike si dhe është vërtetuar përtej çdo dyshimi të bazuar se i akuzuari B. D. ka kryer veprën penale uzurpimi i paligjshëm i pronës së paluajtshme nga neni 320 paragrafi 1 të KPRK-ës, në kohën vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

#### 6.Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Gjykata me rastin e shqiptimit të dënimit ka vlerësuar se të akuzuarit duhet ti shqiptohet dënim me gjobë në shumë prej 500 € (pesëqind euro), të cilin dënim obligohet që ta paguajë në afat prej 15 ditëve nga dita kur ky aktgjykim të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm, ngase duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat dhe provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ky dënim do të jetë i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe përgjegjësinë penale të kryesit, gjithashtu gjykata me rastin e matjes së dënimit ka marrë për bazë edhe rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit duke u bazuar në nenet 69,70, 71 dhe 72 të KPRK-së, ashtu që si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin ka bashkëpunimin e përgjithshëm të personit të dënuar me gjykatën meqenëse i njëjti gjithnjë i është përgjigjur ftesave të gjykatës për pjesëmarrje në seanca gjyqësore në të gjitha fazat e procedurës penale, po ashtu si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin gjykata ka marrë edhe rrethanat personale dhe karakteristikat e personit të dënuar ngase i njëjti është i martuar, baba i tre fëmijëve, është edhe mbajtësi i familjes si dhe faktin se nga shkresat e lëndës shihet se për të akuzuarin është hera e parë që i njëjti bie ndesh me ligjin. Gjykata me rastin e caktimit dhe llojit të lartësisë së dënimit mori parasysh edhe gjendjen ekonomike të të akuzuarit e cila sipas deklaramentit të të akuzuarit është e mesme dhe si rrjedhojë gjykata konsideron se me dënim e shqiptuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi të njëjtit nuk do ti cenohet mirëqenia e tij por njëkohësisht as anëtarëve të tjerë të familjes së tij ndërsa si rrethanë rënduese gjykata për të akuzuarin mori parasysh edhe shkallën e lartë të dashjes të shfaqur nga ana e personit të dënuar meqenëse i njëjti edhe pse e ka ditur se nuk ka asnjë të drejtë ligjore mbi atë hapësirë të bodrumit i njëjti ka ndërmarrë veprimet duke e muratuar pjesën prej 4-5 metra katror dhe duke ia bashkangjitur hapësirës së bodrumit të tij andaj duke u bazuar në të lartcekurat gjykata konsideron se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit duke i marrë parasysh rrethanat e përmendura si më lartë është dënim i drejtë dhe në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të akuzuarit dhe se me këtë dënim mund të arrihen edhe qëllimet e dënimit nga neni 38 të KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale dhe rehabilitimin e tij, parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, shprehja e gjyqimit shoqëror për veprën penale dhe ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

#### 7.Vendimi për kërkesën pasurore juridike.

Sa i përket kërkesës pasurore juridike, si dhe duke pasur parasysh se në këtë çështje penalo juridike është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë se i akuzuari ka kryer veprën penale të uzurpimit të kundërligjshëm të pronës së paluajtshme nga neni 320 paragrafi 1 i KPRK-ës, gjykata vendosi që të akuzuarin ta detyrojë që sipërfaqen e bodrumit si në dispozitiv të këtij aktgjykimi ta liroj në afat prej 15 ditësh nga dita kur ky aktgjykim të merr formën e prerë ndërsa gjykata në kuptim të nenit 463 paragrafi 2, të dëmtuarit për realizimin e pjesës tjetër të kërkesës pasurore juridike i udhëzoi në kontest të rregullt juridiko civil.

#### 8.Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale

Duke pasur parasysh natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare të të akuzuarit, gjykata duke u bazuar në nenin 451 paragrafi 1 të KPP-së, ka vendosur që të akuzuarin ta obligojë që të paguajë paushallin gjyqësor në shumën prej 50 € (njëzet euro) si dhe në bazë të ligjit për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej 30 € (tridhjetë euro), të gjitha këto në afat prej 15 ditëve pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

Andaj duke u bazuar në të lartcekura gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

### GJYKATA THEMELORE NË GJILAN

Departamenti i Përgjithshëm

P.nr.1100/2018, me datë 02.12.2020

Zyrtarja Ligjore,  
Eronita Llapashtica

Gjyqtari i vetëm gjykues,  
Rilind Sermaxhaj

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimin të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet kësaj Gjykate Themelore.